



Datë: 17.03.2025
Numër Protokolli: 1949/2025

A.nr.109/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.109/2025 të datës 15.01.2025 të parashtruar nga ankuesit A.I., B.H. dhe I.H., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesja A.I., kundër Komisionit për Ekspert, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.109/2025, e datës 15.01.2025, e parashtruar nga ankuesit A.I., B.H. dhe I.H.
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr.001/2024 i datës 19.12.2024, i Komisionit për Ekspert.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, A.I., B.H. dhe I.H. (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit*) që të gjithë të punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, më datë 15.01.2025, përmes përfaqësueses së autorizuar ankueses A.I., kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 198/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.109/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.001/2024 të datës 19.12.2024, të Komisionit për Ekspert.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ndërsa ky i fundit më datë 10.02.2025, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimi të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1035/2025 të datës 27.02.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) në këtë çështje juridike administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 198/2025 të datës 15.01.2025, të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin; Kërkesën me numër protokolli 1121/24 të datës 09.12.2024; Vendimin me Nr.001/2024 të datës 19.12.2024; Akt emërimit me numër protokolli 137/2024 të datës 04.05.2020; Vendimi Nr.08/226 të datës 23.10.2024; Dokumente identifikimi të ankuesve; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 10.02.2025; Përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimit me numër protokolli 755/23 të datës 03.07.2023; Pagesat për muajin dhjetor 2024 dhe muajin janar 2025; Akt emërimit me numër protokolli 604/19 të datës 11.06.2019;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është ***e pabazuar, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesit janë të punësuar pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, gjegjësisht sipas Akt emërimeve përkatëse të njëjtin ushtrojnë pozitat e punës *Ekspert Shqyrtues* në Divizionin e Shqyrtimit të Ankesave.

Tutje nga shkresat e lëndës, rezulton se Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, me Vendimin Nr.009/230 të datës 13.11.2024, ka themeluar Komisionin për Ekspert, përgjegjës për pranimin e kërkesave të dërguara nga Zyrtarët Kryesor Administrativë të Institucioneve, si dhe dërgimin në Qeveri për aprovim të Listës së Ekspertëve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Si rrjedhojë, ankuesit përmes U.D Kryetarit të Bordit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, më datë 1121/24 kanë parashtruar kërkesën me numër protokolli 1121/24, tek Komisioni për Ekspert, me pretendimin për kategorizimin e *Ekspertëve Shqyrtues* të këtij institucioni, sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa Komisioni për Ekspert, me Vendimin me Nr.011/2024 të datës 19.12.2024 ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendojnë se plotësojnë kriteret për klasifikim e pozitës së tyre si Ekspert në klasën B7, sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit duke vepruar sipas autorizimeve kushtetues dhe ligjore për mbikëqyrjen e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, më të cilën janë përcaktuar rregullat dhe procedura për zbatim të shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesve ka analizuar pozitat të cilat hyjnë në klasën B7 të kësaj shtojce, nga të cilat janë përcaktuar

këto: *Specialist në fushen e aviacionit civil dhe navigimit ajror; Ekspert kyç në agjenci rregullatore; Ekspert kyç i kualifikuar si Specialist i Sistemeve, Specialist i Rrjetit, Specialist i bazave të të dhënave, Specialist i mbështetjes, për sistemet shtetërore të informacionit e komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore, Drejtues/e i/e Ulet ne Forenzike dhe pozitat e përcaktuara në akt nënligjor; ndërsa në klasën B8, janë përcaktuarkëto pozita: Zyrtar Profesional ne një divizion hetues/operativ ne AKK, Ekspert Forenzik dhe pozitat e përcaktuara në akt nënligjor.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në përcaktimet e pozitave dhe organeve të punësimit të cilat hyjnë në Ekspert/Klasa B7 sipas Shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave materiale të lëndës, vije në përfundimin se pretendimi ankimor i ankuesve lidhur me kategorizimin pozitiv të tyre është i pa bazuar, ngase ashtu siç është theksuar më sipër konstatohet se pozitat e ankuesve *Ekspert Shqyrtues* të prokurimit pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, nuk hyjnë në përcaktimin e shtojcës së lartë theksuar ashtu siç nuk hynë edhe vet organi përkatës i punësimit.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Ekspert i themeluar sipas Vendimit Nr.009/230 të datës 13.11.2024, me rastin e refuzimit të kërkesës së ankuesve ka vepruar në pajtim ligjin material, përkatësisht me dispozitat e të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.22/2024 për Ekspertët, ngase ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, rrjedhimisht Kolegji vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi me Nr.001/2024 i datës 19.12.2024, i Komisionit për Ekspert, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.109/2025, datë 17.03.2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfqësueses së autorizuar të ankuesve, ankueses A.I.;
- Komisionit për Ekspert, i themeluar sipas Vendimit 09/230 të datës 13.11.2024;
- Udhëheqëses e Divzionit të Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.